



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

29 dhjetor 2021

C-IV-13-3917

Ankuesi

G B Prishtinë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 29 dhjetor 2021, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN113-0061, datë 25 nëntor 2013, si i drejt dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 23 dhjetor 2013, ankuesi, dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN113-0061 të datës 25 nëntor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar që të kompensohet për paga të papaguara, në shumë prej 675.50 €, nga NSH “Mulliri” (në likuidim). Ankuesi pohoi se autorizimet për ushtrimin e kërkesave për të gjithë punëtorët i ka pas sindikata e NSH ose komisioni kompetent për këto çështje dhe se nuk ka pasur ushtrim të kërkesave individualisht nga punëtorët. Po ashtu, ankuesi pohoi se shtrohet pyetja se si mund të fajësohen dhe ndëshkohen punëtorët me mosnjohje të një të drejte kur autorizimet për kryerjen e veprimeve i ka pasur sindikata. Më tej ankuesi pohoi se konsideron se AKP më tepër i ruan interesat e veta të ngushta në dëm të punëtorëve, se sa që kujdeset që tua jap apo njoh të drejtat e punëtorëve të cilët janë lënë nën mëshirën e fatit. Ankuesi propozoi që të anulohet vendimi i

kundërshtuar dhe ti njohët e drejta në kompensimin e kërkuar. Ankuesi në mbështetje të ankesës ka dorëzuar vendimin e kundërshtuar.

Me 27 janar 2015, gjykata lëshoi urdhër me të cilin kërkoi nga ankuesi që të dorëzojë autorizimin për përfaqësuesin ligjor dhe dëshmi, prova shtesë nëse ka në mbështetje të pretendimeve të parashtruara në ankesë.

Me 31 janar 2015, urdhri u pranuar nga ankuesi, i njëjti nuk parashtrroi përgjigje.

Me 15 shtator 2017, e paditura parashtrroi mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të drejtë të dispozitave ligjore. E paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është parashkruar pasi që ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim ligjor në lidhje me kërkesën e tij për tre paga brenda periudhës tre vjeçare nga data 11 korrik 2007. Po ashtu e paditura pohoi se afati i parashkrimit nuk e lejon AL ose Dhomën e Posaçme të analizojë dhe shqyrtojë meritat e rastit. Me tej e paditura pohoi se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi lidhur me faktin se përse i takojnë pagat e papaguara dhe kjo dëshmohet për faktin se nuk ka përcaktuar as periudhën e saktë se kur pretendohet te ketë lindur detyrimi. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Me 23 shtator 2017, mbrojtja e të paditurës i është dorëzuar ankuesit, i njëjti nuk parashtrroi përgjigje.

Me 20 shtator 2021, gjykata lëshoi urdhër me të cilin kërkoi nga ankuesi që të parashtrrojë prova shtesë në mbështetje të ankesës së tij, sa i përket bazueshmërisë së kërkesës dhe lartësisë së shumës së kërkuar.

Me 23 shtator 2021, urdhri u pranuar nga ankuesi, i njëjti nuk parashtrroi përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për

të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Ankuesi fillimisht nuk kishte parashtruar prova relevante në procedurën e likuidimit pranë AL-së, për të mbështetur besueshmërinë e kërkesës së tij. Po ashtu, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë kundër vendimit të AL, me të cilat do të mund të dëshmonte se ka ofruar shërbime/punë për NSH dhe se NSH detyrohet për kompensimin e pagave të pretenduara. Ankuesi nuk e ka caktuar as periudhën për të cilën kërkon pagat. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi as lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara, por vetëm ka theksuar shumën e përgjithshme prej 675.50 €. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova në mbështetje të anekses së tij, edhe pas pranimi të mbrojtës së të paditurës dhe urdhrave të gjykatës të datës 27 janar 2015 dhe 20 shtator 2021 duke zgjedhur që të mos përgjigjet në të njëjtit. Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e objektit të kontestit është nën 1,000.00 €.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar